



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1262\_11\_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **26.06.2015**

**në seancën e mbajtur më datë 16 korrik 2015, nxori këtë:**

**V E N D I M**

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit E.M. me shifër DPR- 90090877 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1262\_11\_14** i datës 27.11.2014.

**A r s y e t i m**

Me datë 29.11.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë dalur te konsumatori për të bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 35009729 me gjendje: TL=00001 kWh dhe TU=000001 kWh. Punëtorët e KEDS-it gjatë pranimit të instalimit të njehsorit elektrik po ashtu kanë theksuar se ekziston një njehsor elektrik nr. 145641 me gjendje: TL=002109 kWh dhe TU=000002 kWh, por që nuk i plotëson kushtet teknike pasi që nuk i ka blloibat e institutit.

Departamenti i faturimit në KEDS me datë 04.12.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën nëntor 2013 me **2,108 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **197.72€**. Pas arritjes së kësaj fature konsumatori me datë 13.01.2014 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo korrekt.

Me datë 17.01.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 145641, ku gjendja e njehsorit elektrik në momentin e inspektimit ka qenë: TL=000779 kWh (tarifa e lartë) dhe TU= 000426 kWh (tarifa e ulët).

Me datë 24.01.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 0847499 të datës 17.01.2014. I pakënaqur me përgjigjen e KEDS konsumatori me datë 28.01.2014 ka parashtruar ankesë në DMK/ZRRE, pas kësaj DMK ka bërë shqyrtimin e ankesës së



konsumatorit dhe me datë 01.06.2015 ka nxjerr vendimin me të cilën ka aprovuar ankesën e konsumatorit bazuar në dëshmitë e paraqitura nga palët.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se është i pakënaqur me vendimin e DMK të ZRRE-së, dhe ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që të shqyrtoj edhe njëherë faturat e energjisë elektrike nga periudha 29.11.2013, si dhe disa fatura për vitin 2014, për të cilat konsideron se janë shumë të fryra. Konsumatori në ankesë kërkon që t'i ndërrohet ora digjitale dhe t'i kthehet në pikën matëse ora e vjetër pasi që thekson se ketë orë e ka blerë me mjete të veta.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 korrik 2015 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Lidhur me pikën e parë të kundërshtimit nga ana e konsumatorit që kërkon t'i shqyrtohen edhe njëherë faturat e kontestuara, Bordi ka analizuar edhe njëherë të gjitha këto fatura dhe të gjitha shkresat tjera të lëndës dhe ka konstatuar se vlera e kilovatorëve të regjistruar në njehsorin elektrik është shpenzim të cilin e ka krijuar konsumatori në pikën matëse dhe se ketë shpenzim është i obliguar ta paguaj në bazë të ligjeve dhe rregullave në fuqi. Lidhur me atë se faturat e energjisë janë të fryra, Bordi ka konstatuar se edhe për ketë nuk kemi të bëjmë me fryrje të faturave të energjisë elektrike, por kemi të bëjmë me grumbullim të kilovatorëve të shpenzuar për një periudhë kohore prej 37 ditësh.

Bordi i ZRRE-së, ka konstatuar shkeljet e afateve të bëra nga ana e KEDS-it, pasi që e njëjta nuk ka vepruar konform afateve të përcaktuara ligjore, ku nga shkresat e lëndës shihet se kërkesa e konsumatorit për lidhje të re është bërë me datë 24.10.2013, ndërsa punëtorët e autorizuar të KEDS për pranim të instalimit të njehsorit elektrik kanë bërë evidentimin e shpenzimit të njehsorit elektrik me datë 29.11.2013, që nënkupton se ka kaluar afatin prej tridhjetë ditësh, gjë për të cilën KEDS-i ishte dashur të vepronte më herët për të dalur dhe të bëjë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik, e që i bie se zyrtarizimi/pranimi i njehsorit është bërë pas tridhjeteshtatë (37) ditësh, andaj për ketë arsye është bërë edhe shpërndarja e kilovatorëve dhe korrigjimi i konsumatorit. Pra në momentin e daljes së punëtorëve të KEDS-it për zyrtarizimin/pranimin e njehsorëve elektirik me datë 29.11.2013 aty është evidentuar edhe një njehsor elektrik nr. 145641 me gjendje TL=002109 kWh dhe TU=000002 kWh, dhe se ky njehsor pra shihet se ka pasur shpenzim të energjisë elektrike të regjistruar e për të cilën nuk ka pasur autorizim për ta vendosur, dhe se këtë shpenzim të këtij njehsori është bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për tridhjeteshtatë (37) ditë, pra prej datës 24.10.2013 kur është bërë kërkesa për lidhje të re dhe deri më 29.11.2013 kur është bërë pranimi/zyrtarizimi i njehsorit elektrik.

Pika e dytë e kontestuar në ankesën e konsumatorit se të njëjtit t'i bëhet ndërrimi i njehsorit digjital dhe t'i kthehet njehsori i vjetër elektrik. Bordi për ketë pikë kontestuese ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij është shumë i pakjart dhe kërkesa e tij është e paqëndrueshme pasi që duke pasur parasysh faktin se për lëndën kontestuese kemi të bëjmë me një pikë matëse krejtësisht të re, do të thotë kemi lidhje të re e konsumatorit, andaj edhe një kërkesë e tillë është krejtësisht e pa bazë dhe nuk është edhe objekt i shqyrtimit në ketë lëndë, pasi që në ketë pikë nuk ka pasur asnjëherë njehsor të vjetër elektrik, përveç nëse bëhet fjalë për ndonjë objekt tjetër. Sa i përket njehsorit digjital KEDS ka kompetencë dhe autorizime për vendosjen e këtyre njehsorëve elektrik pasi që të njëjtin janë edhe në përputhje me vendimin e Bordit të ZRRE-së, për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve në sektorin e energjisë. Gjithashtu mbështetur edhe në dispozitat ligjore të Ligjit të



energjisë elektrike theksohet se ndërmarrja e energjisë ka të drejt të përcaktoj tipin, numrin dhe vendin e montimit të pajisjes matëse, si dhe kontrollin përkatës dhe mënyrat e komunikimit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.07.2015 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1262\_11\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar